



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 34 datë 7.8.2020

**“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I GODINAVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE PËR STREHIM SOCIAL (RIKONSTRUKSIONI I
ISH KONVIKTIT TË SHKOLLËS VETERINARE),,**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 7.8. 2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, 54 gërma “dh“, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore“ I ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore“; nenit 6 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar; ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimi nr. 9, datë 20.03. 2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020“ i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 dhe neni 73, pika 2, gërma “dh” të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”; VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe Programit buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër” I ndryshuar, Shkresë nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, Drejtoria e Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020”, administruar pranë nesh me nr. 10391 prot. Datë 22.07.2020 pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë, me 32 vota Pro (votim elektronik),

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të Fondit Rezervë për zbatimin e projektit “ Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)“, nga Programi 4980 fond

reserve, në Programin 10661 “Strehimi Social”, art.231, sipas pakësimeve dhe shtesave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur:

Pakësime:

lekë

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	totali
4980	Fondi Rezerve		Shpenzime të tjera	19,035,000

Shtesa:

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	totali
10661	Strehimi Social	P10661.O2.A4 “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)	Investime	19,035,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lesha

KRYETARE

